



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 18 dhe 20 të Ligjit nr. 06/I-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10 e datës 03 prill 2019, Rregullores (QRK) nr. 09 /2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i dates 24.12.2021 , Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 24.03.2026, pas shqyrtimit të propozim Vendimit mori këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË PALËVE NË PROCEDURËN E DHËNIES NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR DHE AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME

Neni 1

Përbërja e Komisionit

1. Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Bekim Shabani nga ekzekutivi i Komunës,
2. Safete Amerllahu nga ekzekutivi i Komunës
3. Rinor Murati, anëtar i kuvendit nga subjekti politik LDK
4. Agon Bahtiri, anëtari i kuvendit nga subjekti politik PDK
5. Uresa Bytyqi, nga sektori joqeveritar lokal

Neni 2

Mandati i anëtarëve

Mandati i anëtarëve të Komisionit të ankesave është dy (2) vjeçar brenda mandatit të Kuvendit të Komunës.

Neni 3

Detyrat e Komisionit

Komisioni i ankesave shqyrton ankesat e palëve të pakënaqura nga procesi i vlerësimit të ofertave nga komisioni vlerësues, konform procedurave të përcaktuara me dispozitat e

Ligjit nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe Rregullores (QRK) nr. 09 /2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës .
Komisioni bën shqyrtimin e ankesave brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike.

Neni 4

Punët administrative - juridike të Komisionit

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj , Rregulloren e cekur dhe me këtë vendim do ti ndihmojë Zyra Kryetarit të Komunës - Sektori pronësor - juridik.

Neni 5

Kompenzimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre kompenzohen në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Nr. 15-020/04-13696

Lipjan, më 24.03.2026

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN



Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi